

DT 17/09/2019
Nr 227 PRO



SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.120, Tirane
Email: lireng.auditing@gmail.com
Tel/Fax: +355 42 450 952
Mob: 0672079155

Nr. 9 Prot.

Tirane, me 17.09.2019

Per: Asamblene e Pergjitheshme te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar

Per : Z.Viron BEZHANI President i KOKSH

Per : Z.Vojo MALO ZV. President i KOKSH

Per : Z.Genc BOGA Mbajtes i Thesarit i KOKSH

Per : Z.Stavri BELLO Sekretar i Pergjithshem i KOKSH

(Rruga Muhamet Gjollësja, Sheshi Mustafa Q.Ataturku, ish 21 Dhjetori)

Nga: Shoqeria e Auditimit "LIRENG Auditing" Shpk

Tirane

Tirane

Objekt : Dorezimin e Raportit te Auditimit te Pasqyrave Finaciare te vitit 2018 te KOKSH sipas kontrates se sherbimit te auditimit Nr 99 date 23.03.2015

Te Nderuar Zoterinj,

Ne zbatim te misionit te ngarkuar nga Asambleja e Pergjitheshme e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar , Kontrates se Sherbimit te Auditimit Nr. 99 date 23.05.2015 si dhe Shkresave te KOKSH: Nr. 62 date 15.03.2019 "Dergim e Pasqyrave Finaciare te KOKSH te vitit 2018 per auditim " dhe Nr. 218 date 10.09.2019 dergimin e "Bilancit te vitit 2018 te rishikuar" shoqerise audituese "Lireng Auditing" Shpk ka pregatitur raportin e auditimit te Pasqyrave Finaciare te vitit 2018 te KOKSH.Periudha e kryerjes se ketij misioni ka qene ne vartesi te dokumentacionit finciar dhe shkresor qe na eshte vene ne dispozicion nga KOKSH nga fillimi i misionit e deri ne daten e dorezimit te bilancit te rishikuar.

1. (bashkelidh: Raport i auditimit(5flete) dhe Shenimet(23 flete)
2. Shkresen Nr. 62 date date 15.03.2019 e KOKSH derguar audituesit per "Auditimi i Pasqyrave Finaciare te KOKSH per vitin 2018 " bashkelidh Bilanci(5 flete) dhe shenimet e KOKSH te vitit 2018(1 flete)
3. Shkresa Nr . 218 date 10.09.2019 derguar audituesit , bashkelidh "Bilanci i rishikuar i KOKSH i vitit 2018" (7 flete) dhe shenimet e KOKSH te vitit 2018(14 flete)
4. Shkresa Nr 113 date 03.05.2019 e Presidentit te KOKSH drejtuar audituesit(2 flete).

Duke ju falenderuar per bashkpunimin

Me respekt

Per Shoqerin Audituese "LIRENG Auditing" Sh.p.k
Administratori
Neshat Maze(EKR)



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Asamblese se Pergjitheshme Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar
Tiranë (KOKSH)
Tirane, Rruga Muhamet Gjollësja, Sheshi Mustafa Q. Ataturku, ish 21 Dhjetori

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar (OJF) më poshtë "KOKSH" që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, si Pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e aktiviteteve (te ardhurave dhe shpenzimeve sipas funksionit) si dhe Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për këtë vit, dhe të tjera shënime sqaruese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, *(përveç efekteve të mundshme të cështjeve të pershkruara në shtojcën e raportit cështjet në vemendje të drejtimit)* pasqyrat financiare bashkëlidhur **paraqesin drejt**, në aspektet materiale, pozicionin financiar të organizatës më datën 31 dhjetor 2018, performancën e tij financiare *(burimet e te ardhurave të perfituara dhe shpenzimet e aplikuara)* dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këto data, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë pershkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga KOKSH në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së KOKSH për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të KOKSH, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KOKSH.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, *por nuk është një garanci* që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e KOKSH për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e tij. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së KOKSH për vijimësi.

Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e KOKSH, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Çështje ne vëmendje te drejtimit:

1. KOKSH (*siç është paraqitur në shënimin e pasqyrave financiare "Gjendjet e mjeteve monetare ... valutë USD, në datë 31 Dhjetor 2018 "*) nuk ka rivileresuar gjendjen e mjeteve monetare ne monedhe te huaj dollare sipas kursit te publikuar nga banka e Shqiperise me 31 Dhjetor 2018 (per 107.82 lek/\$ nga 120 leke/\$) me efekte ne shumen 1.052,323 leke te cilat u sitemuan ne bilanc gjate periudhes se auditimit .
2. Ne vijimesi ne zbatim te nenit 56 te rregullores se brendshme te funksionimit te KOKSH dokumentacioni qarkullues i hartuar nga zyra e marketingut,menaxhimit te projekteve,

logjistikës dhe të drejtimit (praktika dokumentare urdheruese të përdorimit të fondeve të domosdoshme për dokumentacionin kontabel finaciari) si dhe veçanërisht vendimet e Këshillit Ekzekutiv duhet të dokumentohen për zbatim nëpërmjet zyres së protokollit.

3. Procedurat e ndjekura gjatë vitit 2018 nga KOKSH (Siç është paraqitur në shënimin e pasqyrave financiare "Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2018" paragrafi 5, numri i transfertave të kryera gjatë vitit 2018 është 630 me vlerën 48,169,064.57 Lekë... Urdhër transfertat janë firmosur nga Presidenti ... në 27 raste me vlerë 7,904,060.15 Lekë dhe Sekretari i Përgjithshëm në 603 raste nga të cilat 56 raste janë likuidime të kryera me kartën e debitit të KOKSH...) për leshimin e Urdhër Pagesave (kerkese transfertat) për të tretet me vlerë 5,000 euro në zbatim të nenit 24 të "Rregullores së brendshme e Fuksionimit të KOKSH" rezultojnë të jenë urdheruar (neshkruara) nga Sekretari i Përgjithshëm dhe në disa raste edhe nga Presidenti.

Për rastet e pagesave me vlerë mbi 5,000 euro nga 34 Urdhër Pagesat (kerkese transfertat) me vlerë 36,463,881.00 leke për transferimin e konvertimin e fondeve (mjete monetare) në 10 raste këto Urdhër Pagesat me vlerë mbi 5,000 euro nuk janë neshkruar me dy firmat urdheruese sipas nenit 24 të "Rregullores së brendshme e Fuksionimit të KOKSH" (mungon neshkrimi i firmës depozituese në bankë të Presidentit). Nuk dokumentohet plotësuesi dhe hartuesi i ketyre urdher transfertave.

4. Siç është paraqitur në shënimin e pasqyrave financiare "Shpenzimet në mënyrë të detajuar" në zërin bursa në shumën 5,972,293.57 Lekë ... në rastin kur nuk sjell dokumentacion shpenzimi ..., shumës së caktuar i mbahet 15% tatim në burim ... si për zërin dieta në shumën 1,193,184.70 Lekë) janë kryer pagesat nga llogaritë e KOKSH nëpërmjet shtetit bankar në llogaritë personale të përfituesve mbi bazën e një praktike dokumentare (pa siguar e neshkruar këto shpenzime nga përfituesi, personi që i ka kryer dhe paraqitur këto fatura shpenzimesh). Për këtë në nuk mundem të sigurohem me anë të procedurave alternative në lidhje me vlefshëmerinë dhe plotësinë e ketyre dokumentave faturave shpenzimesh. (sugjerojmë që dokumentacioni i ketyre pagesave të vitit 2018 të rishikohet dhe plotësohet sipas rregullshmerisë financiare).

5. Në shpenzimet për paga personelin paraqitur në shënimet për pasqyrat financiare në shumën 8,739,489.00 lekë janë përfshirë pagat dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2018 për 8 punonjës nga të cilat 4 punonjës janë të përballuara nga fondet e buxhetit të shtetit dhe 4 punonjës të tjerë nga fondet e huaja të solidaritetit. Për 5 pozicione pune pagat baze të caktuara në referencë të kategorizimit të institucioneve buxhetore sipas VKM 187 datë 08/03/2017 dhe VKM 202 datë 15/03/2017 janë rritur për 172,898 leke në muaj (shtesë page bruto) sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv datë 25 Janar 2018 ku cileson: ("...vendosi që pjesa neto e pagës shtesë që merr stafin nga fondi i Solidaritetit Olimpik të mos ndryshojë dhe të mos preket nga rritja e tatimit, por të rritet vlera bruto në përputhje me tatimin." si dhe Vendimi 6/2018 "Komiteti Ekzekutiv vendosi që paga e stafit që merret nga fondin grant nga Ministria së bashku me pagesën që merret nga fondi i Solidaritetit Olimpik në total të rritet në vlerën 10%".

Fondi i pagave i pa akorduar nga buxheti i shtetit për muajin Nëntor-Dhjetor 2018 prej 588,807.00 leke është kompesuar nga përdorimi i fondeve të veta (të huaja) të KOKSH sipas vendimit të KE Nr. 42 datë 7 Dhjetor 2018.

6. Shpenzimet e kryera për shërbime të komunikimeve elektronike sipas faturave tatimore të leshuara nga shoqëria "Vodafone" me vlerë 635.895 leke për 8 numra

telefoni te perdorura nga punonjesit e KOKSH gjate vitit 2018 jane pa kufizim (nuk ka te percaktuar e miratuara fond limit per secilin numer telefoni dhe perdoruesi) Sugjerojme rishikimin e menyres se perdorimit dhe finacimit te shpenzimeve pa limit te numrave te telefonit ne funksion te natyres se vendit te punes qe kryen cdo punonjes.

7. Ne vijim te Shkreses nr. 113 date 03.05.2019 te Presidentit te KOKSH drejtuar audituesit ku cileson”ne zbatim te statutit te KOKSH-it si dhe te kontrates se lidhur midis KOKSH-it dhe shoqerise Lireng Auditing Shpk kerkojme nga ana e juaj qe per periudhen Prill-Qershor 2018 te kryeni auditim te thelluar. Ky auditim te konsistoj:

1. Shpenzimet bankare per periudhen e mesiperme te shoqeruar me dokumentacionin justifikues per kryerjen e tyre.
2. Dokumentacionin justifikues per shpenzimet e kryera me karte debiti te KOKSH.
3. Situacion shpenzimesh te permbledhura sipas formularit bashkelidhur per aktivite qe ka merre pjese KOKSH sipas kalendarit te vitit 2018. “

dhe shenimeve te pasqyrave finaciare te KOKSH nga dokumentacioni i bankes ekstratit te llogarise bankare ne euro rezulton se jane kryer pagesa me Master Card (debiti) te treteve per 56 raste me vlere 19,366.44 euro per blerje paisje dhe sherbime: 3 raste blerje paisje, 7 raste blerje sherbime akomodimi, 15 raste blerje akomodim, 15 raste blerje bileta transporti ajror , 7 raste pagesa domain, hostim (sherbim faqe interneti), 12 raste pagesa promocion aktivite, 2 raste pagesa blerje karburante, 1 rast pagesa blerje taksi, 1 rast pagesa blerje parkim , 3 raste pagesa blerje taks autostrate , 1 rast pagese blerje taks bagazhe shtese dhe 1 rast pagesa blerje vize azere. Ne lidhje me keto pagesa nuk mundem te siguroheshim me ane te procedurave alternative ne lidhje me vlefshmerin dhe plotesin e praktikave se ketyre pagesave te cilat jane kryer pa procedura prokurimi si dhe te vendit dhe personat perdorues te kesaj Master Card (debiti). (Duke qene se perdorimi i Master Card (debiti) eshte e drejte e perdorimit vetem e personave qe kane te drejte firme ne banke, sugjerojme formalizimin e perdorimit te saj mbi bazen e nje procedure konforme dispozitave ligjore kontable).

Ne lidhje me piken 3 te kerkeses nr. 113 dt 03.05.2019 te Presidentit te KOKSH auditim te thelluar per “Situacion shpenzimesh te permbledhura sipas formularit bashkelidhur per aktivite qe ka merre pjese KOKSH sipas kalendarit te vitit 2018 ku kerkohej: “detajimin e shpenzimeve sipas aktiviteve te kalendarit zyrtar, emer mbiemer pjesmarsi, data e fillimit dhe mbarimit te aktivitetit dhe shpenzimet e tyre analitike :bileta ,hotel,dieta,te tjera shpenzime,te paguara me transfertat bankare,te paguara me karta debiti dhe total shpenzime ne leke,euro dhe usd” kjo evidence te dhenash nuk disponohej nga KOKSH e per rrjedhoj ne nuk mundem te siguroheshim me ane te procedurave alternative ne lidhje me regullshmerin e pjesmarresve ne aktivite sportive si dhe te klasifikimit te ketyre shpenzimeve sipas ketij formulari.

8. Shpenzimet per pritje-percjellje jane te dokumentuara me fatura tatimore te neshkuara nga punonjesi i Koksh -it dhe urdher transferetat e leshuar me sigelim te sekretarit te pergjithshem dhe ne disa raste me siglim te presidentit. Ne vijim sugjerojme qe per rastet e praktikave te pagesave per pritje - percjellje te jene te percaktuara fondi limit, numri dhe personat pjesmares ne keto pritje - pecjellje,qellimi i perkatesise se projektit apo aktiviteti per te cilen organizohen.
9. Ne praktiken e dokumentacioit te bankes gjate viti 2018 konstatohet se Urdher Pagesat e kryera per blerje dhe shpenzime te ndryshme ne disa rate nuk jane zbatuar procedurat e blerjeve nga komisioni i prokurimit te krijuar me Urdherin Nr. 1 date 03.01.2018 te

Titullarit dhe vecanerisht per shpenzimet e transportit ajror per shumen 3,782 773 leke. Ne lidhje me proceduren e prokurimeve per vitin 2018 perberja e komisionit te blerjeve jane dy anatar qe nuk jane punonjes te KOKSH.

10. Gjate vitit 2018 (paraqitur në shënimin e pasqyrave financiare në zërin Asistencë Federatave dhe Shokatave, me shumën 11,982,554.41 Lekë” jane leshuar 14 Urdher Pagesa (kerkese transfertat) me vlere 6,569,372 leke ndihme finaciare te pa kthyeshme 7(shtate) federatave sportive me siglim te sekretarit pergjithesem dhe ne disa rate edhe me siglim te Presidentit. Ne lidhje me keto urdher transferta sipas nenit 24 te “Regullore e Brendshme e Funksionimit te KOKSH” ku thuhet “Firmos se bashku me sekretarin e Pergjithshem proces verbalet e mbledhjeve te Komitetit Ekzekutiv” ne dokumentacionin kontabel finaciare mungonin vendimet e KE te vitit 2018 te nenshkruara nga Presidenti dhe Sekretari i Pergjithshem mbi bazen e te cilave duhet te justifikoheshin pagesat e akordimeve te fondeve.

Per akordimin e ketyre fondeve nga ana e KOKSH eshte hartuar nje Regullore “Mbi Proceduren e Mbeshtetes Finaciare” e miratuar nga Komitetit Ekzekutiv me vendim Nr. 32 date 19 Shtator 2018 ndermjet te cilave ne kapitullin VI “Kushtet finaciare” pika 5 citon: “Pagesa e projektit do te behetper cdo shpenzim (blerje ose sherbim) duhet te zbatohet legjislacioni shqiptar” por pa percaktuar se cilat dhe cfare referenca ligjore ekonomike te legjislacionit shqiptar duhet te zbatohen nga akorduesi dhe perdoruesit e kesaj ndihme finaciare.

Ne vijim te kesaj reference ligjore nuk eshte percaktuar baza ligjore e leshimit te 28 Urdher Transfertave me vlere 5,415,983.00 leke nepermjet sistemit bankar nga llogarit bankare te KOKSH ne llogarit bankare te 28 Furnitoreve te ndryshem duke ndryshuar destinacionin e mbritjes te fondeve jo ne llogarit bankare te federatave. Kjo praktike akordim fondi dhe likujdim tek te tretet (Furnitore te ndryshem) dhe jo ne llogarite bankare te federtave sportive eshte bere sipas Vendimit te Komitetit Ekzekutiv nr. 17 date 3 Maj 2018 me cilesimin “ Çdo mbeshtetje financiare qe do te aprovohet pas kesaj mbledhje, nuk do kaloje ne llogari te Federates por Zyra e Finances se KOKSH do paguaje furnitoret pasi Federata te kete paraqitur kontraten me furnitorin/et per produktin/et apo sherbimin/et e ofruar” vendim i cili nuk eshte disponuar ne zyren e finances per zbatim nepermjet formalizimit me shkrese te firmosur nga Presidenti dhe Sekretari i Pergjithshem i KOKSH.


Shoqeria Audituese
“LIRENG Auditing”Shpk
Neshat Maze
Auditues Ligjor

15 Shtator 2019